



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

Programi studimor: Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim

PUNIM MAGJISTRATURE

TEZA:

**“BASHKËPUNIMI DHE KOMUNIKIMI DREJTOR-
MËSIMDHËNËS, FAKTOR NË NGRITJEN E CILËSISË
NË SHKOLLAT FILLORE NË GJILAN”**

Mentori: ARAFAT SHABANI

Kandidatja: DRENUSHE KURTISHI

Tetovë, 2021

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

DEKLARATË E AUTORËSISË	6
DEDIKUAR.....	7
FALËNDERIMI.....	8
ABSTRAKT	9
Fjalët kyçe: menaxhim, cilësi, fillore dhe private, modernizim, komunikim.....	9
ABSTRACT.....	10
HYRJE	11
LËNDA E HULUMTIMIT	14
QËLLIMET E HULUMTIMIT.....	18
HIPOTEZAT.....	21
1.Hipoteza gjenerale.....	21
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	23
RËNDËSIA E PUNIMIT	25
KOMUNIKIMI DREJTOR - MËSIMDHËNËS – QASJA TEORIKE	27
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	36
HULUMTIMI PËR BASHKËPUNIMIN DHE KOMUNIKIMIN DREJTOR - MËSIMDHËS NË SHKOLLAT FILLORE TË KOMUNËS SË GJILANIT	38
Rezultatete e pyetësorit me prindërit në shkollën private “Hello Academy of Education”- Gjilan	39
Grafikoni 1.Gjinia – ‘Hello Academy of Education’	39
Grafikoni 2. Mosha – ‘Hello Academy of Education’.....	40
Grafikoni 3. Edukimi – ‘Hello Academy of Education’.....	40
Grafikoni 4. Pozita – ‘Hello Academy of education’	41
Grafikoni 5. Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj? ‘Hello academy of Education’	41
Grafikoni 6. Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës? ‘Hello Academy of Education’	42
Grafikoni 7. Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ? ‘Hello Academy of Education’	43
Grafikoni 8. Sa jeni të përfshirë në organet e shkollës si institucion i rëndësishëm shoqëror? ‘Hello Academy of Education’	43
Grafikoni 9. Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë? ‘Hello Academy of Education’	44
Grafikoni 10. Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ? ‘Hello Academy of Education’	44
Grafikoni 11. Jeni pjesë e vizionit të shkollës? ‘Hello Academy of Education’	45
Grafikoni 12. Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë? ‘Hello Academy of Education’ ..	45

Grafikoni 13. I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës? ‘Hello Academy of Education’	46
Grafikoni 14. A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ? ‘Hello Academy of Education’	46
Grafikoni 15. A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësimeve dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arritjeve të shkollës si institucion edukativo – arsimor ? ‘Hello Academy of Education’	47
Grafikoni 16. A jeni të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë ? ‘Hello academy of Education’	47
Rezultatet e pyetësorit me prindërit në shkollën shtetërore “ Musa Zajmi “ – Gjilan	48
Grafikoni 18. Mosha – ‘Musa Zajmi’	49
.....	49
Grafikoni 19. Edukimi – ‘Musa Zajmi’	49
Grafikoni 20. Pozita - ‘Musa Zajmi’	50
Grafikoni 21. Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj? ‘Musa Zajmi’	50
Grafikoni 22. Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës? ‘Musa Zajmi’	51
Grafikoni 23. Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ? ‘Musa Zajmi’	51
Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë?	52
Grafikoni 25. Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë? ‘Musa Zajmi’	52
Grafikoni 26. Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ? ‘Musa Zajmi’	53
Grafikoni 27. Jeni pjesë e vizionit të shkollës? ‘Musa Zajmi’	53
Grafikoni 28. Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë? ‘Musa Zajmi’	54
Grafikoni 29. I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës? ‘Musa Zajmi’	54
Grafikoni 30. A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ? ‘Musa Zajmi’	55
Grafikoni 31. A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësimeve dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arritjeve të shkollës si institucion edukativo – arsimor ? ‘Musa Zajmi’	55
Grafikoni 32. A jeni të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë ? ‘Musa Zajmi’	56
Rezultatet e pyetësorit me mësimeve në shkollën private “ Hello Academy of Education “ – Gjilan	57
Grafikoni 33. Gjinia e mësimeve – ‘Hello Academy of Education’	57
Grafikoni 34. Mosha e mësimeve – ‘Hello Academy of Education’	57
Grafikoni 35. Edukimi i mësimeve – ‘Hello Academy of Education’	58

Grafikoni 36. Pozita e mësimeve – ‘Hello Academy of Education’	58
Grafikoni 37. Jam i kënaqur me komunikimin, punën dhe angazhimin e drejtorit në shkollë? ‘Hello Academy of Education’	59
Grafikoni 38. Kam raporte të mira me drejtorin – ‘Hello Academy of Education’	59
Grafikoni 39. Sjellja e drejtorit të shkollës ndaj meje është e kënaqshme – ‘Hello Academy of Education’	60
Grafikoni 40. Drejtori është motivues në punën time si mësues – ‘Hello Academy of Education’	60
Grafikoni 41. Drejtori është pjesë e sukseseve të mia në shkollë – ‘Hello Academy of Education’	61
Grafikoni 42. Drejtori është iniciues i ngritjes time akademike - ‘Hello Academy of Education’	61
Grafikoni 43. Drejtori është mbështetës në punën time si mësues – ‘Hello Academy of Education’	62
Grafikoni 44. Jeni pjesë e vendimmarrjeve në shkollë? - ‘Hello Academy of Education’	62
Grafikoni 45. Jeni pjesë e vizionit të shkollës?’ Hello Academy of Education’	63
Grafikoni 46. Drejtori përpiqet që t’i kuptojë nevojat e tua profesionale rreth mësimit - ‘Hello Academy of Education’	64
Grafikoni 47. Drejtori ju monitoron orën tuaj mësimore në shkollë? - ‘Hello Academy of Education’	64
Grafikoni 48. Drejtori ju jep informata kthyes pas monitorimit të orës suaj? ‘Hello Academy of Education’	65
Grafikoni 49. A pajtoheni se mësuesit duhet të jenë pjesë aktive e qeverisjes së shkollës? - ‘Hello Academy of Education’	65
Grafikoni 50. A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit dhe mësimeve ndikon në ngritjen e të arritjeve të shkollës si institucion edukativ- arsimor? ‘Hello Academy of Education’	66
Grafikoni 51. A pajtoheni se roli i udhëheqësit të shkollës duhet bazuar në monitorimin dhe përkrahjen e stafit të shkollës? ‘Hello Academy of Education’	67
Grafikoni 52. A pajtoheni se mësuesit duhet të jenë pjesë kyçe në zbatimin e aspekteve të aktuale të Kurrikulës së re? ‘Hello Academy of Education’	68
Rezultatet e pyetësorit me mësues në shkollën shtetërore “Musa Zajmi” – Gjilan	69
Grafikoni 53. Gjinia e mësimeve - ‘Musa Zajmi’	69
Grafikoni 54. Moshë e mësimeve - ‘Musa Zajmi’	69
Grafikoni 55. Edukimi i mësimeve - ‘Musa Zajmi’	70
Grafikoni 56. Pozita e mësimeve – ‘Musa Zajmi’	70

Grafikoni 57. Jam i kënaqur me komunikimin, punën dhe angazhimin e drejtorit në shkollë? 'Musa Zajmi'	71
Grafikoni 58. Kam raporte të mira me drejtorin – 'Musa Zajmi'	71
Grafikoni 59. Sjellja e drejtorit të shkollës ndaj meje është e kënaqshme –'Musa Zajmi'	72
Grafikoni 60. Drejtori është motivues në punën time si mësimdhënës – 'Musa Zajmi'	72
Grafikoni 62. Drejtori është iniciues i ngritjes time akademike - 'Musa Zajmi'	73
Grafikoni 63. Drejtori është mbështetës në punën time si mësimdhënës – 'Musa Zajmi'	74
Grafikoni 64. Jeni pjesë e vendimmarrjeve në shkollë? –'Musa Zajmi'	74
Grafikoni 65. Jeni pjesë e vizionit të shkollës? - 'Musa Zajmi'	75
Grafikoni 66. Drejtori përpiqet që t'i kuptojë nevojat e juaja profesionale rreth mësimdhënies? - 'Musa Zajmi'	76
Grafikoni 67. Drejtori juaj monitoron orën tuaj mësimore në shkollë? – 'Musa Zajmi'	77
Grafikoni 68. Drejtori ju jep informate kthyesë pas monitorimit të orës suaj? – 'Musa Zajmi' ..	77
Grafikoni 69. A pajtoheni se mësimdhënësit duhet të jenë pjesë aktive e qeverisjes së shkollës? - 'Musa Zajmi'	78
Grafikoni 70.A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit dhe mësimdhënësve ndikon në ngritjen e të arriturve të shkollës si institucion edukativo- arsimor? - 'Musa Zajmi'	79
Grafikoni 71.A pajtoheni se roli i udhëheqësit të shkollës duhet bazuar në monitorimin dhe përkrahjen e stafit të shkollës? - 'Musa Zajmi'	80
Grafikoni 72. A pajtoheni se mësimdhënësit duhet të jenë pjesë kyçe në zbatimin e aspekteve të caktuara të Kurrikulës së re? - 'Musa Zajmi'	81
Përgjigjet nga anketa për udhëheqës të shkollave – për shkollën shtetërore.....	82
Përgjigjet nga anketa për udhëheqës të shkollave – për shkollën private	84
PËRFUNDIMI	86
PYETËSORI PËR UDHËHEQËS TË SHKOLLAVE	88
Për shkollën private	88
PYETËSORI PËR MËSIMDHËNËS	91
Pyetëtori për prindër	94
Protokolli i intervistës	97
Intervistë gjysmë e strukturuar.....	97
PYETËSORI PËR UDHËHEQËS TË SHKOLLAVE	98
Për shkollën shtetërore	98

DEKLARATË E AUTORËSISË

Unë, deklaroj me vetëdije si dhe me ndërgjegje të plotë se ky punim është rezultat i punës sime të pavarur dhe jam plotësisht e vetëdijshme që plagjiarizëm konsiderohet kopjimi i punës së bërë nga të tjerët dhe paraqitja e saj si punë e imja.

Në çdo rast të vetëm në këtë punim mbështetja e tërthortë apo citimi i drejtëpërdrejtë në punën e autorëve të tjerë është e deklaruar si e tillë. Unë jam plotësisht e vetëdijshme që plagjiarizmi rezulton automatikisht me notë negative dhe do të pasojnë masa disiplinore që mund të shpijnë deri të marrja e së drejtës për të qënë student në Universitetin e UEJL-it.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Data, Vendi

Aprovuar nga:

Data, Vendi

Mentor i Punimit

Data, Vendi

Antar

Data, Vendi

Antar

Data, Vendi

DEDIKUAR

“ No one who achieves success does so without the help of others. The wise and confident acknowledge this help with gratitude ” – Alfred North Whitehead

Në shenjë mirënjohje këtë punim ia dedikoj njeriut që më ka mbështet gjatë tërë këtij udhëtimi dhe që vazhdon të jetë mbështetësi më i madh i imi, bashkëshortit tim – Driton Kurtishit.

FALËNDERIMI

Falënderimi i takon *Zotit* në radhë të parë që më ka ndihmuar, pasi ky punim ka qenë shumë sfidues.

Falenderoj profesorët prof. Dr. Arafat Shabanin, prof. Dr. Demush Bajramin dhe prof. Dr. Hasan Jasharin për mbështetjen dhe ndihmën që më kanë dhënë gjatë punimit të tezës së diplomës.

ABSTRAKT

Bashkëpunimi dhe komunikimi drejtor - mësimdhënës, është thelbi i punës kërkimore shkencore. Në kuadër të këtij studimi do të paraqesim të gjitha të dhënat teorike dhe shkencore, përfshirë dhe ato empirike. Gjithë këto të dhëna do të japin një panoramë realiste dhe do të shërbejnë dhe si tentative në ngritjen e cilësisë në shkollat fillore në qytetit e Gjilani në Republikën e Kosovës. Kjo temë e përgatitur në nivel të thirrjes shkencore magjistër, përmban disa tema dhe nëntema, të cilat do të trajtohen si të veçanta duke ndarë ato teorike nga ato empirike. Do t'u përmbahemi metodologjisë së punës shkencore dhe në bazë të literaturës së shfrytëzuar dhe konsultimeve me mentorin prof.dr. Arafat Shabani, do të paraqesim dhe rezultatet e këtij studimit. Punimi përmban temat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe komunikimin në raport mes drejtorit të shkollës dhe mësimdhënësit, komunikimin drejtor dhe staf punonjës, ngritja e cilësisë së shkollës, duke marrë në analizë një shkollë publike dhe një private.

Në fakt thelbi i këtij punimi të magjistraturës është komunikimi, dhe kjo si një rëndësi buron nga funksionet e saj që ushtron një drejtor në raport me mësimdhënësit. Këto pika do të zhvillohen më poshtë dhe mund të themi të gjitha këto pika janë të lidhura ngushtë me funksionin e menaxhuesit të saj, drejtorit, menaxherit. Në rastin tonë studimi do mbështet në një hapësirë të caktuar ku gravitojnë disa shkolla fillore dhe do merren si bazë studimi disa drejtor të shkollave fillore të komunës së Gjilanit edhe atë në dy shkollat fillore: "*Musa Zajmi*" – Gjilan, shkollë publike dhe "*Hello Academy of Education*" – Gjilan, shkollë private. Fakti që jam dhe mësimdhënëse në njërën nga këto shkolla synojë që studimi të këtë bazë shkencore, analitike dhe objektive për të dhënë në fund një kontribut modest shkencor.

Fjalët kyçe: menaxhim, cilësi, fillore dhe private, modernizim, komunikim

ABSTRACT

Cooperation and communication between the principal and the teacher, is the core of scientific research. The framework of this study will present all the theoretical and scientific data, including the empirical ones. All these data will give a realistic overview and will serve as an attempt to increase the quality of primary schools in the city of Gjilan, in the Republic of Kosovo. This thesis prepared at the level of the scientific Master's Degree consists of several topics and sub-topics, which will be treated as specific by separating the theoretical from the empirical ones. The thesis will adhere to the methodology of scientific work and based on the literature used and consultations with the mentor Prof. Dr. Arafat Shabani the results of this study will be presented. The paper contains topics related to cooperation and communication in the relationship between the principal of the school and the teacher, the communication between the principal and the staff, raising the quality of the school, therefore, the study was completed by taking into account a public and a private school.

Indeed, the essence of this master's thesis is communication, thus, this as a significance results from its functions practiced by a principal in relation to the teachers. These major points will be developed below and we can say all these are closely related to the function of its manager, the director and the manager. In our case, the study will be based on a certain space where some primary schools gravitate and some principals of primary schools in the municipality of Gjilan will be taken as the study base, therefore there are used two primary schools: "Musa Zajmi – Gjilan", public school and "Hello Academy of Education" - Gjilan, private school. The fact that I am also a teacher in one of these schools includes my aim for this study to have a scientific, analytical and objective basis to eventually give a modest scientific contribution.

Keywords: Management, Quality, Primary and Private, Modernization, Communication

HYRJE

Shkolla në fakt paraqet një sistem pune shoqërore e organizuar qëllimisht për interesa të caktuara të shoqërisë dhe kombit. Ajo vepron si nënsistem në gjirin e një komuniteti shoqëror. Elementet të cilat e lidhin shkollën në një komunitet të caktuar janë: drejtori, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit e nxënësve; grupet shoqërore, politike, fetare; grupet pedagogjike; autoritetet lokale administrative; mjedisi i përgjithshëm. Këto elemente janë në lidhje të ndërsjellë. Por lidhjet më të theksuara bashkëvepruese janë ato të relacionit: drejtor-mësimdhënës, e që formojnë njëkohësisht një lëvizje trekëndor bashkë me nxënësit. Shkolla e organizuar moderne ka mekanizma adekuate që e mbajnë në lidhje të vazhdueshme administratën, nxënësit, mësimdhënësit, dhe efektet e një pune të mirë vijnë si pasojë e një komunikimi të mirë të ndërsjellë. Organizimin e saj e cilëson ecja me kah në zbatimin e tri funksioneve bazë: marrja e vendimeve, udhëheqja dhe administrimi, zbatimi i vendimeve të marrura. Ajo arrin efektivitet kur vë në funksionim marrëdhënie dhe bashkëveprim të përhershëm këta tre funksione bazë. Tani shtrohet pyetja se vallë nevoja për ndryshimin e shkollës është domosdoshmëri apo dëshirë? Si pikë e parë do të ilustroj se ç'janë ndryshimet në shkollë për t'u orvatur më tutje të tregoj se vallë a janë ato ndryshime të domosdoshme apo janë dëshirë e ndokujt. Me ndryshime në shkollë kuptohet shndërrimi ose transformimi i shkollës psh. fizionomia e shkollës, jeta dhe marrëdhëniet e reja në të, ndryshohet raporti dhe kuptimi mbi pozitën e nxënësit nga ana e shkollës etj, dhe mirëkuptimi mes drejtorit dhe mësimdhënësve.

Duket filluar nga personi, njeriu, *drejtori* duhet të jetë personalitet me nivel të dalluar intelektual, me cilësi organizative dhe me kulturë menaxheriale, derisa, nga aspekti shpirtëror duhet të jetë i ekuilibruar emocionalisht, i matur dhe i paanshëm në marrjen e vendimeve dhe i matur në aspekt të komunikimit me stafin e tij, e aq më shumë në raport me mësimdhënësit brenda shkollës.

Drejtori i shkollës duhet të jetë bashkëpunues me shumë organe ndër to edhe me këshillin drejtues të shkollës, me këshillin e prindërve, me këshillin e nxënësve, me këshillin e arsimtarëve, si dhe me këshillin e klasave dhe aktiveve profesionale. Prandaj, duke qenë të vetëdijshëm për rolin e padiskutueshëm të tyre, institucionet përkatëse të arsimit të Komunës së Gjilanit e kanë rregulluar edhe me ligj funksionim dhe fushëveprimin e organeve të shkollës dhe në rastin tonë të

studimit për analogji kemi dhe një shkollë private ku administrimi dhe komunikimi drejtor – mësimdhënës është modern dhe civilizues.

Me gjithë ndryshimet që ka pësuar e do pësojë, menaxhimi i shkollës në këto komuna, shpesh duke ndërhyrë dhe politika në emërimin e drejtorëve, do të jetë pothuajse vazhdimisht një faktor që e dallon si institucion edukativ – arsimor në zhvillimin e saj dhe ndikon në menaxhimin e saj. Tre elemente qenësore pedagogjike e përcaktojnë menaxhimin e arsimit fillor dhe përmirësimin e procesit mësimor: menaxhimi, komunikimi dhe organizimi. Menaxhimi është kushti i parë që shkolla të shkon drejt zhvillimit dhe realizimit të qëllimeve dhe objektivave. Me zhvillim të shkollës nëpërmes menaxhimit të mirë, përmes menaxherit të shkolluar si i tillë dhe më dije dhe vizion të mirë, me ide dhe plane afatgjate, nënkuptojmë aktivitetin e gjerë që ndërmerret në kuptim të përcjelljes, organizimit, hulumtimit, përparimit dhe ndryshimit të veprimtarisë së tërësishme edukative – arsimore.

¹ Ky proces *operacionalizohet* në veprime konkrete të cilat mendojmë si t'i analizojmë dhe krahasojmë pasi të kemi mbaruar pjesën empirike të studimit, përmes studimit në vend, duke intervistuar drejtor shkolle, duke anketuar mësimdhënës, dhe duke marrë bazë studimore të gjendjes së shkollës fillore në drejtoritë arsimore të kësaj komune të lënë anash nga shteti.

Pra me menaxher, duhet të nënkuptojmë edhe investimin e përpjekjeve që të arrihet ajo që planifikohet. Ne e dimë se planet e shtetit janë në letër, por sa ato zbatohen konkretisht, një menaxher i mirë di të sigurojë fonde dhe mundësi tjera për të ngritur nivelin e shkollës me idenë që mos pengohet mësimi, cilësia të ngritet, dhe të bashkërenditet në kuadër të shkollave moderne. Gjithë kjo vjen si pasojë e ideve të vyera të menaxhuesit. Organizimi i mirë i punëve është i rëndësishëm për arritje të rezultateve. Esenca e zhvillimit të shkollës qëndron në ndryshimin, organizimin pedagogjik dhe reformën e brendshme të saj. Siç është menaxhimi i arsimit kusht i

¹ Operacionalizimi si term nënkupton hapat që ndërmerren për zhvillim si; hartime të planit dhe programit të punës; Analizë kritike e punës që bëhet me projektim të zhvillimit; Studimin dhe hulumtimin e problemeve mësimore e shkollore; Nxitjen e bashkëpunimit për zhvillim dhe përparim të shkollës; Angazhimin e drejtpërdrejtë për zbatimin e inovacioneve në shkollë; Vështirime dhe analiza të vazhdueshme për zhvillimin e shkollës; Organizimin racional të shkollës dhe e veprimtarisë pedagogjike në të; Nxitjen dhe zhvillimin teknologjik të shkollës; Zbatimin e teknologjive të përparuara mësimore; Planifikimi për zhvillimin e burimeve njerëzore në zhvillimin profesional të tyre etj.

parë për të ecur drejt zhvillimit, ashtu është edhe komunikimi dhe organizimi, përndryshe pengesat dhe dështimet janë implicite dhe peramamente.

Po pse duhet ndryshuar shkolla domosdoshmërisht? Pasi ajo me gjithë rëndësinë që e ka është e mbyllur dhe rezistente ndaj risive dhe nuk mund t'i përshtatet risive çdoherë, mandej dominon ende stili autoritar - kërcënues që është pjesë e tradicionales, ende kemi kurrikula të stërngarkuara etj. Arsytet për ndryshime në shkollë janë të domosdoshme pasi që shkolla duhet të afrojë një arsimim cilësor - kualitativ. Në vijim shpalos edhe arsyet e tjera se pse shkolla duhet të ndryshojë dhe ky ndryshim a mund të arrihet përmes bashkëpunimit të ndërsjellë drejtor-mësimdhënës? Si pikë e parë ajo, pra shkolla duhet të shkojë në hap me kohën dhe tu përshtatet zhvillimeve të gjithëmbarshme e që duhet këtë ta bëjë medoemos, të ndryshojnë mënyrat e punës, të zhvillohet përpos mësimi edhe këmbimi i vlerave, të vendoset rregullorja për vënien e uniformave për nxënësit dhe arsimtarët dhe së fundi të futet domosdoshmërisht elementi i kërkimit, gjurmimit apo hulumtimit i cili i mundëson nxënësve të mësojnë se si të mësojnë, apo të mësojnë më pak e të gjykojnë, respektivisht mendojnë më shumë.

Në literaturën e kësaj fushe studimore gjejmë edhe përdorimin e termeve tjera për menaxhimin e shkollës, si shprehjen “qeverisje e shkollës”, (Bakman&Trafford, 2007) e cila nënkupton një menaxhim modern e demokratik, të bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut, autorizimin, gjithëpërfshirjen, etj. Pra, drejtorët në punët e tyre duhet t'i kenë parasysh shumë faktor, të rëndësishme operative dhe strategjike, si legjislacionin, kurrikulat (planprogramet), autoritetet kompetente, pastaj prindërit dhe nxënësit, si dhe gjendjen socio-ekonomike të mjedisit, në mënyrë që puna e tyre të kurorëzohet si e suksesshme.

Krahas termit “qeverisje”, përdoret edhe termi “administrim” (Bakman & Trafford, 2007), por që kanë dallime në përmbajtjen e tyre, prandaj preferohet të përdoret shprehja “qeverisje demokratike e shkollës”, duke pasur për bazë efektivitet më të mira në menaxhimin e arsimit. E që të lehtësohen rrethanat e një qeverisjeje të suksesshme, pa dyshim se rol thelbësor ka autoriteti i drejtorit, i cili nënkupton fuqinë ndikuese dhe vepruese ndaj të tjerëve, si kategori morale, profesionale dhe shoqërore e njohur dhe e vlerësuar gjithandej nga literatura përkatëse

LËNDA E HULUMTIMIT

Bashkëpunimi dhe komunikimi drejtor – mësimdhënës paraqet një proces të rëndësishëm dhe si i tillë meriton vëmendjen e shkencës. Zhvillimi si proces synon shkolla të kalojë në një fazë të re e më të përsosur. Ky zhvillim mund të jetë me shpejtësi dhe i ngadalësuar. Zhvillimi tregon shkallën e përparimit. Menaxhimi i shkollës, roli i menaxhuesit të shkollës në aspekt të komunikimit me mësimdhënësit, nënkupton aktivitet dhe proces të planifikuar dhe sistematik të tërë veprimtarisë së shkollës si në aspektin vertikal ashtu edhe në atë horizontal, në dimensionin pedagogjik dhe atë social dhe personalitet të aftë dhe me vizion për menaxhim. Këto nuk janë vetëm teori të thata por elemente që duhet ndjekur për një rritje më të madhe të cilësisë në arsim. Në këtë vijë rol të rëndësishëm luajnë dhe arsimtarët.

Bashkëpunimi dhe komunikimi në raportin e lartëshënuar paraqet studim të rrethanave në të cilat gjendet shkolla dhe niveli i cilësisë së shkollës. Çka paraqet mjedis të mirë shkollor dhe me cilësi të lartë? Kush mund ta krijojë atë? Çka nevojitet? Këto janë disa nga pyetjet, që udhëheqësit e shkollave, arsimtarët dhe prindërit shpesh herë i parashtrojnë. Janë disa pika në të cilat do të ndalemi detajisht dhe do t'i analizojmë. Padyshim ambienti pozitiv në shkollë ruhet përmes krijimit të standardeve kundër dhunës në të gjitha format e saj. Kjo mund të arrihet vetëm përmes një qasjeje sistematike dhe të gjithanshme të tërë shkollës për zhvillimin dhe implementimin e politikës së sjelljes. Në këtë drejtim arsimtarët duhet të luajnë një rol të veçantë. Në përditshmërinë e punës së tyre, arsimtarët duhet të përcaktojnë shembuj për krijim të një ambienti, në të cilin qasjet pozitive dhe proshoqërore përdoren për t'iu referuar problemeve ndërpersonale.

Rreth përkufizimit të kuptimit menaxhues ose menaxhimit si proces në literaturë e në praktikë përdoret paralel menaxhim dhe drejtim. Domethënia e tyre është identike. Ja si e përcakton këtë Fjalori i gjuhës shqipe: menaxher është ai “Që merret me organizimin e me drejtimin e veprimtarisë së një organizate, të një ndërmarrjeje a institucioni...”²Drejtues është “Ai që organizon dhe drejton punën e veprimtarinë e një ndërmarrjeje, të një institucioni, të një

² Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 2077

organizate...”³. Drejtori në arsimin fillor duhet të krijojë modelin e shkollave të hapura, të cilat promovojnë metoda aktive të të nxënësve, të cilat integrojnë teknologjinë e re informatike-komunikuese në mësimdhënie dhe të cilat përpiqen të sigurojnë mjedis stimulues, në të cilin nxënësve u jepet mundësi që ta realizojnë plotësisht potencialin e tyre.

Duke e përkufizuar menaxherin e shkollës, mendoj se elementet të rëndësishme që e shprehin personalitetin e tij si menaxhues janë:

- Karriera dhe imazhi pedagogjik i menaxherit është në plan të parë.
- Entuziazmi, energjia dhe shpirti i iniciativës duhet ta karakterizojë atë.
- Menaxheri duhet të tregojë sens për organizimin e punës në shkollë dhe zhvillimin e saj.
- Nga nisma e punës së menaxherit është paanshmëria e cila duhet të jetë gurthemel i transparencës.
- Menaxheri duhet të ketë kuptim për përsosjen permanente dhe zhvillim të shkollës.

Natyrisht, pa pretendime në një definicion gjithëpërfshirës, mendoj se menaxhimi i arsimit është një sistem dhe proces që reflekton praktikën e avancuar arsimore, kulturore, teknologjike të cilat bazohen si në promovimin e tendencave të reja në shkollë, strategjitë e menaxhimit modern e bashkëkohore dhe mbrojnë ligjshmëritë e organizimit të punës në shkollë dhe zhvillimin e saj. Personaliteti i menaxherit luan një rol të ndjeshëm në zhvillimin e shkollës.

Ai është faktor për krijimin e dinamikave të ekuilibruara në shkollë. Hulumtimet, studimet e mëhershme, studime që kanë dalë si formë doracakësh dhe matjes nga terreni, studimet e USAID-it, studimet shkencore në nivel të shtetit, kanë treguar se drejtorët dhe mësimdhënësit duhet të ndërtojnë marrëdhënie partneriteti të bazuara në komunikimin e ndërsjellë, në detyrimet dhe përgjegjësitë e përbashkëta gjatë edukimit dhe arsimimit të fëmijëve dhe gjatë organizimit të jetës shkollore. Por, në praktikë akoma ekziston qasja tradicionale e roleve të ndara të tyre, ku shkollat

³ Po aty, f. 373

kanë përgjegjësi për organizim të mësimdhënies së mirë, kurse prindërit një faktor i rëndësishëm në ruajtjen e cilësisë së shkollimit duhet të kujdesen për rrethanat shtëpiake të fëmijëve.

Në librin e tij “Pedagogjia e përgjithshme”, autori Gaston Maillaret, duke fol për drejtimin e shkollave, shkruan: “Me shefa të shkollave ne kemi parasysh personat e pajisur me autoritet në bashkësinë e një grupi shkollash dhe, praktikisht, në të gjitha vendet ekziston në çdo shkollë një person i caktuar për të qenë përgjegjës për atë që ndodh në shkollë.”⁴

Pse menaxhimi dhe cili është roli i menaxherit në shkollën fillorë në Komunën e Gjilanit, në atë private dhe atë shtetërore?

Si fillim mendojmë se struktura e paraqitur e problemit menaxher – drejtues, është e njëjtë. Menaxhimi nënkupton reflektimin ndaj shumë komponentave arsimore e shkollore, e më tej ajo gjithashtu nënkupton një praktikë gjithëpërfshirëse mbi një strukturë komplekse që i jepet menaxhimit në shkollën konkrete. Pyetja pse menaxhimi e jo drejtimi, ka të bëjë me një kontekst më të gjerë të trajtimit dhe të kuptimësisë së saj. Këtu ndeshemi me relacionin pedagogjik – shoqëror e normativ mes menaxhimit dhe drejtimit. Mendojmë se termi menaxhim është më adekuat mbase është gjithëpërfshirës, përfshin më shumë fusha të procesit arsimor në shkollë, të menaxhimit dhe zhvillimit të saj. Analizat tona tregojnë se menaxhimi përfshin një strukturë të gjerë pedagogjike, edhe pse menaxhimi dhe drejtimi kanë skemë ideale të përbashkët.

Në përgjithësi menaxhuesit përpiqen të ndryshojnë atë që i shqetëson: cilësinë e menaxhimit dhe ndërtimin e kapaciteteve të shkollës për zhvillim dhe realizimin e detyrave. A ka shkolla kapacitet për realizimin e detyrave? Përgjigja jonë është, gjithsesi, pozitive. Por ai kapacitet është i ndryshueshëm.

Në librin e tij “Kuptimi i ri për ndryshimin në arsim”, M. Fullan, duke shtruar çështjen e kapacitetit të shkollës për realizimin e detyrave, vlerëson (sipas Njumann) se kapaciteti përbëhet nga pesë përbërës:

“1. Njohuritë, aftësitë, shprehjet dhe prirjet e mësuesve,

⁴ Gaston Maillaret, Pedagogjia e përgjithshme, Prishtinë, 1997, f. 142

2. Bashkësia profesionale,

3. Koherenca e programit,

4. Burimet teknike dhe

5. Menaxhimi i drejtorit”.⁵

Nga këto del të konkludojmë se ajo që duhet bërë është menaxhimi i mirë i shkollës në mënyrë që ajo të zhvillohet. Të gjithë subjektet duhet të kontribuojnë në zhvillimin e saj.

⁵ Majkëll Fullan, Kuptimi i ri për ndryshimin në arsim, Edualba, Tiranë, 2001, f. 221

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Qëllimet e hulumtimi të kësaj teme janë disa:

1. Fillimit kam pasur për qëllim t'i nxjerrë në pah kërkesat objektive të një menaxhimi të suksesshëm të shkollës fillore në Komunën e Gjilanit dhe duke analizuar komunikimin drejtor - mësimdhënës, respektivisht cilësitë e drejtorit të shkollës fillore publike dhe privat, si parakusht për një shkollë të suksesshme.
2. Krahas kësaj është vënë në spikamë edhe domosdoshmëria e bashkëveprimit edhe të organeve tjera drejtuese të shkollës me menaxherin, respektivisht roli përcaktues i menaxherit në këtë aspekt.
3. Qëllimi i studimit është të përcaktojmë, studiojmë, gjurmojmë si në aspektin teorik dhe atë empirik për rolin e menaxhuesit në arsimin fillor në komunën ku edhe jap mësim, pra Komuna e Gjilanit. Studime të tilla, në këtë vend, nuk ka, mbase studime gjithëpërfshirëse kemi disa dhe të njëjtat do ti konsultojmë, por qëllimi jonë është nxjerrja në sipërfaqe e disa të dhënave shkencore rreth menaxherit, në një komunë ku shkolla fillore përballet me kushte të rënda, sfidat e një drejtori, idetë dhe rekomandimet për përmirësimin e kësaj gjendje. Arsimitarët dhe drejtori shpesh herë ankohen se nuk kanë respekt ndaj njëri – tjetrit. Këtë raport e ka prishë ndërhyrja politike në arsim, punësimi politik, mësimdhënësit e partizuar dhe drejtori politik... respekti vërehet në pranimin e të drejtave dhe përgjegjësisive të të tjerëve. Ai reflektohet gjatë komunikimit përmes fjalëve, qëndrimeve dhe veprimeve edhe të drejtorit por edhe të mësimdhënësit.

Kur iu drejtohem mësimdhënësve me respekt, shfaqim sjellje që i përmirëson marrëdhëniet mes njerëzve, mundësojmë që kur edhe ata të ballafaqohen me situata, në të cilat duhet të zgjidhin konflikt, do të përcaktohen për sjellje të ngjashme, gjegjësisht do të shfaqin respekt. Kjo reflektohet dhe në klimën pozitive brenda klasës dhe reflekton pozitivitet para syve të nxënësve. Për të qenë të respektuar, duhet respektuar të tjerët, e në veçanti duhet respekt ndaj njëri – tjetrit.

Arsimtarët efektiv përdorin metoda të llojllojshme varësisht nga situata.⁶

Pyetjet kërkimore të hulumtimit që dalin teksa punon temën: Realizimit të hulumtimit i paraprijnë edhe pyetjet kryesore :

1. Si qëndron komunikimi drejtor - mësimehënës në shkollën tuaj dhe cilat janë vështirësitë që i hasni më shpesh rreth menaxhimit të shkollës?

2. Kush e harton planin zhvillimor të shkollës, sa bashkëpunon drejtori me mësimehënësit për këtë temë të ndjeshme?

3. Sa i merr drejtori në konsideratë mendimet e mësimehënësve në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë, në çfarë niveli është ky lloj komunikimi?

4. A mbështet menaxheri nismat progresive të mësimehënësve dhe a nxit kualifikimin profesional?

Pikërisht duke iu shmangur këtyre kriterëve dhe duke e bërë përzgjedhjen e drejtorëve sipas premisave të tjera, qoftë nga ndërhyrjet politike, qoftë të atyre familjare, pra nepotizmit, vërehen lëshime dhe defekte në menaxhimin e shkollave të ndryshme në të gjitha nivelet në vend, dhe pikërisht këtu duhen parë edhe rezultatet e shkollave, ngase në disa shkolla mund të ketë lëshime dhe mangësi aty ku menaxhimi ngec dhe në anën tjetër, ka rezultate konkrete në ato shkolla ku menaxhimi është në nivel. „Shkolla - familja - komuniteti, janë faktorët më të rëndësishëm për edukimin dhe arsimimin e brezit të ri. Bashkëpunimi në mes tyre është i lidhur ngushtë me qëllimin e përbashkët, që: të përgatisin fëmijë të edukuar mirë, të përshtatur, të mençur, të aftë dhe të shkathët për jetë etj.” (A. Deva, Zuna & bashkëpunëtorët, 2009)

Për të hyrë në problemin në fjalë fillojmë me pyetjet vijuese: A i kanë shkollat punonjësit të aftë profesionalisht, dhe menaxhuesit e standardit bashkëkohor? Dallim esencial i shkollës private dhe asaj publike në këtë aspekt? Si duhet të jetë një drejtor i mirë? Pse në pikën e udhëheqjes ka ende botëshikim politik? Çfarë është organizimi i menaxhimit dhe pse ai është i rëndësishëm? Çfarë rolesh mund të ketë menaxheri, me çfarë situatash dhe sfidash mund të

⁶ Murati Xh. “Didaktika e suksesit”, Luma, Tetovë, 2013, f.56

përballet në shkollë? Cilat janë tiparet dhe karakteristikat personale të tij? Stilet e komunikimit pro-social, heqja e gjuhës ndëshkuese, krijimi i gjuhës shpërblyese... Gjatë krijimit të konceptit për komunikim publik, duhet të merret parasysh përbërja e përzier e banorëve të komunitetit, gjuhët dhe traditat e ndryshme të komunitetit. Në një shkollë, në secilën derë, që prej kuzhinës deri në tualete, ishte shënuar në pesë gjuhë të ndryshme emri i dhomës së caktuar, me qëllim që fëmijët të orientohen dhe të lëvizin më lehtësisht. Gjithashtu, duhet të kushtohet vëmendje që takimet të mos lihen në data të cilat janë festa religjioze ose kombëtare, me çka do të respektohen diferencat kulturore. Të përdoren mjete teknologjike që lehtësojnë komunikimin. Proverbi: “Një foto flet sa për 1000 fjalë” tregon se si mjetet vizuale (shenja, fotografi, postera, video) mund të kontribuojnë për zgjidhjen e problemit. Mediumet janë të fuqishme për shkak se shumë shpejt e përcjellin informacionin te lexuesi. Ajo që mund ta tërheqë vëmendjen e gazetarit, gjithashtu mund ta tërheq edhe vëmendjen e lexuesit. Posterat e krijuar nga ana e fëmijëve e tërheqin vëmendjen më shumë sesa posterat e shtypura nga të rriturit. Një organizatë e cila u përpoq t’i përmirësojë shërbimet mjekësore për fëmijët me nevoja të posaçme, përpunoi transparent gjigant me fotografi me ngjyra të forta me qëllim që të tërheqë vëmendje. Me këtë, u theksua serioziteti i problemit dhe u tërhoq vëmendja e reporterëve lokal. Kur problemi u bë aktual në nivelin e të gjithë komunitetit, spitali lokal siguroi shërbime plotësuese – trajnoi “asistentë” të cilët zbatuan terapi fizikale për fëmijët me nevoja të posaçme prej shkollës lokale.

Komunikimi drejtor - mësimpldhënës kërkon standard. Standardet profesionale për mësuesin janë pjesë përbërëse e një kuadri më të gjerë dokumentesh që përfshijnë të gjithë sistemin arsimor. Këtu bëjnë pjesë edhe standardet për drejtorin e shkollës, për trajnerin, për mentorin, nëndrejtorin pedagogjik etj. Hartimi i standardeve profesionale të mësuesit synon profesionalizimin e mësimpldhënies, që do të thotë marrjen në konsideratë të mësuesisë si një profesion që duhet standardizuar ashtu si profesionet e tjera, për të qenë në harmoni me partnerët e tjerë social dhe me grupet e interesit, ndërsa për drejtorin vlejnjë gjithë standardet që ai i fiton me rastin e licesnimit të tij, dhe dijet t’i zbatojë në praktikë. Standardet e komunikimi pozitiv do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat për zhvillimin e tij profesional. Kur mësuesi synon që të kalojë në një shkallë tjetër të karrierës së tij, atëherë standardet e asaj shkalle do të shërbejnë si pikë referimi për zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesit. Por nëse disa mësues nuk do të dëshironin që të avancojnë në karrierë, atëherë, në këto raste, standardet i ndihmojnë të kërkojnë dhe të gjejnë

mundësi për të zgjeruar dhe për të thelluar përvojat e tyre brenda shkallës së karrierës në të cilën ndodhen. Drejtori duhet të jetë përkrahës i mësimdhënësit.

HIPOTEZAT

1.Hipoteza gjenerale

Gjatë studimit do të tentohet në bazë të analizave nga terreni t'i jepet përgjigje pyetjes së: A ka komunikim mes drejtorit dhe mësimdhënësit dhe si shfaqet ky lloj komunikimi në Komunën e Gjilanit? A ka progres dhe sa ndikon ky raport komunikimi në rritjen e cilësisë në arsim? Do të përgatiten pyetësor për drejtor dhe mësimdhënës. Matjet do bëhen në shkollat e paracaktuara. Si kanë ndikuar ndërhyrjet politike në vlerën e menaxhimit të shkollës publike dhe si të privatja? Shkollat tek të cilat do të bëhet hulumtimi në terren janë paracaktuara më lartë. Ne kemi sot një shkollë shembull dhe modern të komunikimit drejtor - mësimdhënës në komunën e Gjilanit si pasojë e një punë të ndershme dhe të menaxhuar mirë nga ana drejtorit të shkollës. Studimi jonë do na dërgoj te mënyrat se si të përmirësohet gjendja e përgjithshme e arsimit fillor në këtë komunë.

Hipoteza të ngjashme dhe shumë pikëpyetje tjera dalin përgjatë punimit, dhe se kjo temë nuk është trajtuar më herët, në këtë komunë, me këta drejtor, do synojë të bëjë studim të rrallë dhe si i tillë do tu jepet dhe drejtorive arsimore për të kuptuar gjendjen e përgjithshme të arsimit fillor dhe të marrin masa drejt përmirësimit, mos e shohin drejtuesin e shkollës si person i cili duhet të punësojë militant partiak, por ta lënë të lirë shkollën dhe drejtuesit të menaxhojë me nder, pa politikë, por me ndihmë nga ministria përmes fondeve, teknologjive bashkëkohore në arsim.

- 1. Supozohet se një numër i madh i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm kanë ndikim të madh në bashkëpunimin dhe komunikimin drejtor - mësimdhënës në shkollat filllore të Gjilanit - hipoteza kryesore*

2. *Supozohet se bashkëpunimi dhe komunikimin i mirëfillt drejtor - mësime dhënë në shkollat fillore ndikon drejtpërsëdrejti në ngritjen e cilësisë dhe suksesin e shkollës*
3. *Bashkëpunimi drejtor – mësime dhënë si një hallkë e rëndësishme drejt suksesit*
4. *Bashkëpunimi drejtor – mësime dhënë rreth zgjidhjes së problematikave brenda shkollës*
5. *Bashkëpunimi drejtor - mësime dhënë rreth trajnimeve që duhet t'i përcjellin mësime dhënësit për hirë të ngritjes së cilësë së shkollës, qoftë ajo private ose publike*
6. *Do të tentojmë të zbulojmë faktorët e komunikimit jo të mirë mes drejtorit dhe mësime dhënëseve*
7. *Do të japim shembuj dhe përgjigje të të anketuarve rreth komunikimit me drejtor - mësime dhënë*
8. *Do të tentojmë të zbulojmë se si ndikon teknologjia bashkëkohore e komunikimit në rritjen e cilësisë në arsim.*
9. *A e kemi gjendjen e rënduar në arsim shkaku i komunikimit jo në nivel të raportit drejtor - mësime dhënë.*
10. *Si ndikon politika prej anësh në cilësinë e arsimit*
11. *A është drejtorit i shkollës një meritë apo i dërguar politik e komunal.*
12. *Krahasim i shkollës privat dhe shtetërore në aspekt të komunikimit drejtor - mësime dhënë, analogjitë, përparësitë, modelet...*

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për tu përgatitur ky punim janë përdorur këto metoda; metoda e analizës teorike, metoda e sintezës, metoda përshkruese, metoda krahasuese (komparative), metoda statistikore. Studimi empirik kërkon mund dhe kohë, dalje në terren dhe analizë të informatave që do nxirren nga pyetësorët.

Përmes metodës së analizës kemi analizuar literaturën përkatëse që lidhet me objektin e hulumtimit dhe përgjigjet e dhëna në pyetësor, të cilat i kemi përmbledhur përmes metodës së sintezës. Me anë të metodës statistikore kemi paraqit të dhëna statistikore dhe në fund përmes metodës përshkruese kemi përshkruar rezultatet e hulumtimit.

Si instrumente për mbledhjen e të dhënave kemi përdorë PYETËSORËT PËR DREJTOR, MËSIMDHËNËS dhe PRINDËR të dy shkollave fillore në këtë komunë. Do të paraqiten pyetësor të cilët do tu përgjigjen drejtorët e këtyre shkollave: një shkollë private dhe një publike në komunën e Gjilanit. Në shkollën fillore ‘Musa Zajmi’ Gjilan shkollë publike me 600 nxënës dhe 52 mësimitdhënës, ku 11 meshkuj dhe 41 janë femra, do të realizohet pyetësor me 20 pyetje, dhe në fund do të bëhet elaborimi i përgjigjeve në forma statistikore dhe me grafikone.

Njëkohësisht do të realizohet edhe një pyetësor tjetër në shkollën fillore ‘Hello Academy of Education’ është shkollë private me 400 nxënës, e cila ka 40 mësimitdhënës ku 27 janë femra dhe 13 meshkuj.

Në pyetësorin për drejtor të shkollave në gjithsej 20 pyetje ndoshta dhe me shumë, të cilat lidhen me punën dhe detyrat e drejtorit dhe rolit të tij në menaxhimin e shkollës në komunën e Gjilanit dhe do të rishtojmë nëpërmjet përgjigjeve raportet që kanë mësimitdhënësit dhe drejtorët. Pyetësori do të përmbajë pyetje për të dhënat personale, për gjininë, moshën, kualifikimin, të

dhënat mbi përvojën e punës profesionale si mësimdhënëse dhe si drejtor. Nga kjo do nxjerrim dhe përgjigjen se pak ka femra në pozicione të drejtuesit.

Në pyetësorët në këto dy shkolla të paracaktuara, do të anketohen gjithsej 20 mësimdhënëse dhe 20 prindër. Pyetje do të jenë nga fusha e interesimin tonë, nga përgjigjet e tyre do nxjerrim një elaborim të gjerë, dhe përmes paraqitjeve grafike do ta japim dhe një pasqyrë të qartë të gjendjes së komunikimit dhe raportit që kanë mësimdhënësit dhe drejtori në këtë drejtim. Gjithsesi do të marrim parasysh dhe kuadrot e reja të cilat realisht janë dhe shpresa e kapërcimit të kësaj gjendje në të mirë të përparimi të shkollës. Do theksoj në veçanti rolin e mësimdhënëseve femra dhe anashkalimin e tyre për pozicione drejtor - sekretar, është kjo një gjendje e shoqërise partiarkale apo thjesht përcaktimi politik dhe diferencës gjinore?!

RËNDËSIA E PUNIMIT

Duket nisur studimin në këtë komunë, shkolla që është private është më e sofistikuar në bashkëpunimin dhe komunikim drejtor – mësime, kurse në shkollat që janë publike ende nuk ka ardh ky modernizim i partneriteti midis drejtorit dhe mësime.

Drejtuesit e shkollave po që se janë të dobët, dyfish më dobët do jetë cilësia në arsim. Ata kanë në dorë shkollën, klasën, nxënësit, ligjin. Pse përmenda në fund, ligjin, sepse një drejtori i mirë, ndjek ligjin, dhe e zbaton atë se e ka frikë thyerjen e ligjit, për një drejtor të ndershëm ligji për arsim fillor është i shenjtë, në rast të kundërt, drejtori i ardhur nga selia e partisë nuk e zbaton ligjin, sepse bën të fortin, dhe kështu nuk mund të presim rezultate pozitive por një rrënim gradual të cilësisë dhe vetë imazhit të shtëpisë së shenjtë siç është shkolla. Duke e pranuar udhëheqjen si proces të veçantë nuk është e drejtë që ajo të shikohet e ndarë dhe e shkëputur nga subjektet e tjera, të cilat participojnë në procesin zhvillimor të shkollës.

Udhëheqësi si pjesë përbërëse dhe personalitet kryesor në shkollë duhet ta mbështes punën në disa parime themelore dhe t'i demonstrojë aftësitë dhe cilësitë e kërkuara për realizimin e procesit zhvillimor. Parimet janë të rëndësishme mbase udhëheqësi ka përgjegjësi dhe pushtet. Pikërisht këto parime i morëm në shqyrtimin vijues.

Të gjitha parimet nisen nga katër elemente:

- Persosshmëri në mënyrën dhe formën e sjelljes,
- prezantimin e personalitetit,
- mënyrën e komunikimit dhe
- rolin në udhëheqjen e shkollës (ekipit, grupit, aktivitetit, shërbimit, këshillit, etj.).

Cilësia e punës, efektiviteti dhe suksesi në udhëheqjen e shkollës duhet të mbështetet në parime. Parimet bazë të udhëheqjes së shkollës e në të cilat udhëheqësi duhet ta mbështes veprimin e tij, sipas mendimit tonë janë: uniteti i veprimeve, qëndrueshmëria e qëllimit, përgjegjëshmëria, profesionalizmi, bashkëpunimi, cilësia, motivimi, udhëheqja efektive me resurset, qëndrimi pozitiv ndaj problemeve, demokratizimi, etika e komunikimit, rregullimi normativ, sistematizimi, të jetë i rëndësishëm dhe respekti.

Ndërkaq, sipas B. Kovaçević parimet e udhëheqjes janë:

“- Parimi i qartësisë së qëllimit,

- Parimi i kooperimit,

- Parimi i ekonomizimit dhe racionalizimit,

- Parimi i efikasitetit,

- Parimi i kontrollës”.⁷

Por, këto parime s’ duhet parë si të ngurta. Ato shprehen në mënyrë konkrete në çdo situatë të udhëheqjes. Të gjithë udhëheqësit nuk posedojnë të njëjtën cilësi në organizimin e shkollës ashtu siç rekomandohet, madje janë larg cilësisë nga udhëheqësit e shkollave të përparuara evropiane.⁸ Parimet e udhëheqjes janë rregulla të cilat duhet të respektohen në të gjitha fazat e organizimit dhe punës së shkollës. Parimet themelore të udhëheqjes garantojnë udhëheqjen cilësore dhe rrjedhën normale të zhvillimit të shkollës.

⁷ Bogosav Kovačević, Ergoloshke osnove organizacije nastave, Shkolska knjiga, Zagreb, 1977, f. 67 - 101

⁸Kam parasysh udhëheqjen, organizimin dhe komunikimin në shkollat urbane dhe në ato rurale, në shkollat e mëdha (mamute) dhe në ato të vogla, në shkollat në shoqëritë e demokratizuara dhe ato në tranzicion etj.

KOMUNIKIMI DREJTOR - MËSIMDHËNËS – QASJA TEORIKE

Në këtë syth studimi, do të trajtojmë në aspektin teorik dhe shkencor gjithë infomacionin që ka të bëjë me komunikimin drejtor shkolle me mësimdhënësit duke plotësuar dhe të dhëna tjera që shënojnë nisma pozitive për cilësinë në arsim.

Drejtuesit e shkollës, drejtorët, duhet t'i njohin mirë barrierat që pengojnë gjatë komunikimit: mungesa dhe mangësitë e planifikimit, problemet semantike dhe gjuhësore, interpretimet e ndryshme të informacionit është një pengesë tjetër kryesore në komunikim ku informacioni shpërndahet në individë të ndryshëm, shkalla e të dëgjuarit, informacionet e tepërta.⁹

Komunikimi është një fushë e gjërë dhe si e tillë ajo është përherë e varuar nga ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur me mjetet e komunikimit e të shkëmbimit të informacioneve. Dimë se në ditët e sotme kanë shtuar shumë rolin dhe rëndësinë që ka fluksi i informacioneve dhe shpejtësia e komunikimit në rritjen e efektivitetit të menaxhimit të shkollave dhe me këtë edhe të procesit edukativ dhe arsimor.

Gjithë studimi do mbështetet në punën në terren të shkollave fillore të komunës së Gjilanit edhe atë në dy shkollat fillore: ‘*Musa Zajmi*’ – Gjilan, shkollë publike dhe ‘*Hello Academy of Education*’ – Gjilan, shkollë private.

Cilësia dhe arritja e suksesit në shkollë, në ditët tona, varet në mënyrë të ndjeshme nga aftësitë komunikuese me mësimdhënësit brenda dhe jashtë shkollës. Pavarësisht, nëse bëhet fjalë për procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit apo për raportet ndërnjerëzore në mjedisin shkollor, sukcesi ose dështimi ka lidhje direkte me aftësitë për të komunikuar. Raporti komunikues drejtor – mësimdhënës është i një rëndësie të madhe.

⁹ Koxhaj A. & Tomini F “Manaxhimi I komunikimit”, Afërdita, Tiranë, 2003, f.330

Komunikimi është veprimtaria e shkëmbimit të informacionit kur marrësi e kupton dërguesin. Komunikimi mund të përkufizohet si mjeti me anën e të cilit individët arrijnë të shkëmbejnë midis tyre informacionet për operacionet dhe veprimtaritë që realizohen në një organizatë ose është një proces nëpërmjet të cilit mendimi krijohet dhe dërgohet për të krijuar kuptueshmërinë e gjërave. Për rëndësinë dhe rolin e komunikimit kanë shkruar shumë autorë të njohur e të ndryshëm. Kështu për shembull, Chester I. Barnard thekson se: “Komunikimi duhet të zërë një vend qëndror në teorinë e organizimit për shkak se struktura, gjerësia e shtrirjes dhe fushat e organizimit përcaktohen pothuajse tërësisht nga teknikat e komunikimit”¹⁰. Gjithashtu sipas tij, funksioni kryesor i një ekzekutivi është ndërtimi dhe mbajtja e një sistemi të caktuar dhe efikas të komunikimit.

Komunikimi shërben si një mjet i rëndësishëm, me anën e të cilit shkolla lidhet edhe me mjedisin e jashtëm. Komunikimi edhe pse nuk përfaqëson veprimtari të dukshme të rëndësishme të shkollës, ai luan rolin e gjakut që i jep jetë dhe e bën shkollën të ekzistojë. Në fakt, komunikimi konsiderohet efektiv vetëm kur të tjerët e kuptojnë mesazhin tuaj në mënyrë korrekte dhe ju përgjigjeni në mënyrën e duhur.¹¹

Njohim edhe komunikologjinë si shkencë që merret me kuptimet dhe efektet e ndërveprimit simbolik të njerëzve me qëllimin që të kuptohen ndërmjet tyre. Xhon Fisk thotë se komunikologjia studion procesin e mbartjes së porositve dhe reflektimin e tyre.

Të dhënat për arsimin fillor dhe të mesëm në kohën e socializmit në vendbanimet e banuara me shqiptarë tregonin sjellje diskriminuese me qëllim që ajo popullatë të mos shkollohet, të mbetet e gjymtë dhe të paraqes instrument të eksploatimit. Krahas kësaj dhe autonomisë së shtuar të shkollave sipas ligjeve ekzistuese, edhe detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit kanë ndryshuar.¹²

Termet komunikologji dhe komunikim nuk janë identik. Komunikimi është proces themelor që mundëson vazhdimësinë dhe funksionimin e bashkësisë njerëzore. Komunikimi është raport ndërmjet dy a më shumë subjekteve, mënyrë marrëveshjeje ndërmjet njerëzve, faktor bazë

¹⁰<http://www.centrum.mk/wp-content/uploads/2016/01/275-285.pdf>, autor: Rexhep Dauti, magjistër i Pedagogjisë.f.2

¹¹ Karaj, Th. & Tamo, A., Th. Psikologjia, tekst mësimor për shkollën e mesme të profilizuar, profile shoqëror, Tiranë, SHBLSH, 2003, fq. 156,

¹² Hasan Jashari. Ese te filozofise politike. Arberia Design, Tetove, 12 / 2010. ISBN ISSN:978-608-4503-4.,f. 105

për të mbijetuar shoqëria, kurse informimi i jep përmbajtje këtij raporti. Ai njofton dhe ka ndikim. Komunikologjia është veprim, proces njoftimi mes njerëzve, kumtim. Është krijimi i lidhjeve dërguese dhe kthyesë; është proces dinamik dhe përherë i ndryshueshëm. Komunikologjia, si shkencë, në krahasim me shkencat tjera, është formuar vonë. Lindja e parë si shkencë është kushtëzuar nga paraqitja e komunikimeve masive. Që të shmangim keqkuptimet e mundshme gjithnjë duhet të jemi të vetëdijshëm se në çfarë mënyre jemi duke komunikuar.¹³ Nëpërmjet komunikimit, nëpërmjet formave të ndryshme, mund të shprehim fakte, mendime ose ndjenja, por rregulli kryesor është se me tjetrin duhet sjellë ashtu sikurse duam ai të sillet me ne gjatë një situatë të caktuar. Shkolla mbetet insitucioni ndaj të cilin duhet të jemi të përgjegjshëm. Shkollimi është proces që na shpie drejt së ardhmes së sigurt. Shkollimi është fushë më e rëndësishme e një shoqërie dhe kombi. Nëpërmjet shkollimit si proces, shoqërisë u transmetohen dije, kulturë, vlera ku përmes tyre shkon një shoqëri përpara. Arsimi jo vetëm që i prin shoqërisë, në të njëjtën kohë ndikohet edhe nga ndryshimet që ndodhin në shoqëri. Një ndër çështjet më të rëndësishme në arsim janë edhe reformat. Reforma në arsim do të thotë të vihet në zbatim politika e fundit, përmes saj të ndryshosh, kulturen e klasave, shkollave, univerzitetëve. Me anë të reformave, arsimi është munduar t'ju përshtatet sa më shumë ndryshimeve sociale në rrethinë po si dhe atyre globale.¹⁴

Kemi disa lloje komunikimesh: verbal, joverbal, me shkrim, me ndërmjetësim etj, të cilat janë të lejuara për përdorim të komunikimi zyrtar, drejtor - mësimdhënës.

Komunikimi verbal na mundëson të komunikojmë shpejt dhe të kemi informatë kthyesë (feedback). Nëpërmjet një komunikimi joverbal ne mund të shprehim emocionet tona, por mund të krijojmë edhe perceptim të gabuar të bashkëbiseduesi. Lëvizjet e trupit ose gjestet mund të ndikojnë te pranuesi gjatë interpretimit të mesazhit.

Komunikimi i shkruar na mundëson të komunikojmë në largësi kohore dhe hapësinore, të lexojmë disa herë mesazhin e shkruar, ta analizojmë dhe ta vërtetojmë, por e meta është se nuk kemi feedback.

¹³Murati Xh. Komunikologjia dhe teknika e komunikimit, Tetovë, 2005.

¹⁴Hasan Jashari. Sociologjia e arsimit. In *Sociologjia*, pp. 263. Interlingua, Skopje, 7 / 2005. ISBN 9989-173-01-x, f. 193.

Njeriu dallon nga qeniet tjera, sepse është i vetëdijshëm për veprimet e tij. Ai gjatë procesit evolutiv kaloi nëpër disa faza, gjegjësisht:

1. *Fazën e përvetësimit të natyrës* nëpërmjet punës, që është faza qytetëruese, kultivuese (*homo haber*).
2. *Fazën e ndërveprimit njerëzor* nëpërmjet komunikimit (*homo symbolicum, homo communicens*).

Shoqëria është *kusht i ligjërit*. Nëpërmjet komunikimit realizohen proceset biologjike dhe riprodhuese, që ka ndodhur në të gjithë fazat dhe format e organizimit të bashkësisë njerëzore: nga format elementare (grupet primare) deri te format më të ndërlikuara (bashkësitë shtetërore apo ndërshtetërore - BE); nga shoqëritë primitive (grupet, fiset), deri te shoqëritë moderne (shoqëritë informative).

Ndryshimi i formave komunikuese ndikoi në përparimin esencial të njeriut. Këto ndryshime quhen edhe revolucione komunikuese.

Komunikimi nëpërmjet gjuhës në raporin drejtor – mësidhënës mundëson shkëmbime të informacioneve, zhvillim, përcjellje përvoja, kujtese e tradite kolektive, por edhe identifikim dhe identitet gjuhësor. Pasi gjuha është mjeti për ushtrimin e pushtetit të fjalës, në kombinim me dukurinë komplekse të identifikimit dhe identitetit gjuhësor, përfshihet natyrshëm në marrëdhëniet e forcës, të pushtetit, etj.

Sipas teoricienit të mediave Marshall McLuhan, gjatë historisë së qytetërimit njerëzor janë zhvilluar tre lloje kulturash komunikimi: **auditive**, **vizuale** dhe **elektronike**. Komunikimi drejtor – mësimdhënësi mund të realizohet pikërisht përmes këtyre formave të lartëpërmendura.

Kultura e komunikimit auditiv. Është forma më e lashtë e komunikimit njerëzor, që ka lindur dhe është zhvilluar në mënyrë spontane përgjatë zhvillimit të njeriut.

Komunikimi nëpërmjet të dëgjuarit dhe të folurit realizohet nëpërmjet gjuhës, që është mediumi vendimtar. Gjithashtu, mund të përcillet edhe me manifestime jogjuhësore: të kollitje, ofshama etj.

Kultura e komunikimit vizual. Është formë komunikimi që filloi prej se njeriu përdori shenjat. Me zbulimin e shtypshkronjës fitoi karakteristika të tjera. Përfshin format gjuhësore dhe jogjuhësore. Format gjuhësore janë gjuha e shurdhmemecëve, semafori etj. Format jogjuhësore janë shprehjet nëpërmjet fytyrës, gjesteve etj.

Kultura e komunikimit elektronik. Ekziston për më shumë se një shekull, që nga shpikja e telegrafit. Zbulimet teknike dhe teknologjike kanë ndikuar në të gjithë lidhjet komunikuese. Ndikim të madh patën: shpikja e TV, makinave llogaritëse (kompjuterëve), celularëve etj.

Komunikimi është një proces i imët, kompleks, por ai nuk mund të jetë një akt i thjeshtë, një proces me rrjedhje të qetë, pra me zhvillim horizontal, pasi brenda tij gjejmë ndërveprime në përputhje ose mos përputhje interesash me afrim dhe me shmangie, me mirëkuptim dhe keqkuptim, me konsensus dhe tolerancë, por dhe intolerancë.¹⁵ Për t'i shkuar më tej problemit të komunikimit duhet pasur parasysh, aftësia e të folurit, që në këtë mjedis, si tregues kryesor ka përdorimin e fjalëve të kuptueshme, shqiptimin e saktë, formulimin e pyetjeve të thjeshta, si dhe kthimin e përgjigjeve të qarta. Me vlerë është rritja e vëmendjes për të dëgjuar bashkëbiseduesin, për të kuptuar mirë problemin, për të dalluar opinionet nga faktet. Komunikimi, mënyra e të folurit nuk duhet të jetë e dhunshme që mund të shkaktojë shqetësime. Ekzistojnë shumë shkaqe të gabimeve në komunikim, por më kryesoret janë: kushtet objektive konkrete, mungesa e kapaciteteve në godinat shkollore, mjeteve dhe pajisjeve mësimore, teksteve dhe fletoreve, pra kaosi i një mjedisi, si dhe veprimtaria në zona të thella, ngarkesat e veta ekonomiko-sociale e psikologjike. Pamjaftueshmëria e dijeve dhe përvojës, veçanërisht vakumi i krijuar nga mosnjohjet e sferave afektive dhe motivacionale të veprimtarisë psikike, mungesat e përgjithshme në arsim dhe kualifikim e veçanërisht kur ai nuk ka përvojë. Niveli sot ende i papërsosur i shkencës pedagogjike e psikologjike dhe i modeleve, metodave dhe mjeteve diagnostikuese etj. Por e rëndësishme është që gabimi të mos jetë si pasojë e pakujdesisë, nënvleftësimit, neglizhencës dhe veçanërisht mungesës së etikës profesionale.

¹⁵ Grup autorësh, "Studio gjithçka, arsyes vendin e parë", AEDP, Tiranë, 1998, f. 384

Për të komunikuar nevojiten njerëz që ekzistojnë si qenie sociale dhe racionale. Ata paraqesin publikun, ose komunikantët. Këtë gjë duhet të bëj shpesh drejtori për të informuar mësimmshënësit përmes komunikave dhe njoftimeve.

Edhe pse tradicionalisht me komunikim nënkuptohet këmbimi verbal i mesazheve, megjithatë gjuha nuk është mjeti i vetëm shprehës; prandaj gjatë komunikimit më me rëndësi është që të kuptojmë informacionin e pranuar, pavarësisht mënyrës së pranimiit.

Komunikimi, si proces, përfshin tre dimensionet e jetës njerëzore: të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.

Për realizimin e një lëvizje të shpejtë dhe efektive të informacionit të domosdoshëm, udhëheqësit e shkollave qysh në momentin e projektimit organizativ duhet të mbajnë parasysh komunikimin, i cili do të realizohet në katër drejtime të ndryshme: komunikim vertikal nga lartë – poshtë, komunikim nga poshtë - lartë, komunikim horizontal dhe komunikim diagonal. Pra, marrja e informacionit për një diapazon të gjerë çështjesh që preokupojnë, jo vetëm mësimmshënësit, por edhe drejtuesit e tyre, i ndihmon këta të fundit që të përcaktojnë vendime sa më efektive qoftë për të zgjidhur një problem të dhënë, por po ashtu edhe për të eliminuar rezistencën e stafit të mësimmshënësve për ndryshimin e politikës udhëheqëse në lidhje me çështje të procesit mësimor dhe çështje të tjera të shkollës. Përvoja ka treguar se në ato shkolla ku komunikimi vertikal poshtë - lartë mungon, apo nuk funksionon ashtu siç duhet, problemet janë më të mëdha pasi mësimmshënësit e ndjejnë veten të mënjanuar nga çështjet që përcaktojnë organizatën, ndërsa distanca midis tyre dhe drejtuesve është e madhe sepse drejtuesi ose refuzojnë të dëgjojnë mësimmshënësit ose kanë kontakte jo të mjaftueshme me ta.

Komunikimi horizontal si fluks i informacionit ndërmjet individëve të cilët ndodhen në të njëjtin nivel hierarkik në shkollë, është i rëndësishëm jo vetëm për drejtuesit, por edhe për punëtorët e tjerë. Pa këtë lloj komunikimi nuk mund të realizohet koordinimi i funksionimit të aktivitetit edukativ dhe arsimor në shkollë. Për mësimmshënësit, të cilët punojnë bashkërisht dhe komunikojnë rregullisht me njëri - tjetrin, rrallëherë mund të ndodhë që të ketë probleme të mirëkuptimit midis tyre. Ndërveprimi u jep atyre gjithashtu, mbështetje emocionale dhe i ndihmon për të kënaqur nevojat e tyre të komunikimit social dhe në grup. Shpeshherë drejtuesit pohojnë se pengesat në komunikim janë një nga problemet më serioze me të cilat ata ndeshen në praktikë.

Pengesat e komunikimit në mjaft raste shërbejnë për të paralajmëruar ekzistencën e problemeve më të thella, prandaj një drejtues shkolle nuk duhet t'i marrë gjërat shumë sipërfaqësore, por duhet që ta trajtojë çështjen në mënyrë më të detajuar për të zbuluar shkaqet e vërteta të barrierave të komunikimit.¹⁶

Shumica e drejtorëve të shkollave bëjnë përpjekje për të siguruar sjelljet etike dhe për rrjedhojë komunikimin e moralshëm nëpërmjet përpunimit dhe shpalljes të detyrueshme të rregullave të punës. Megjithatë, kyçe për zhvillimin e komunikimit etik në shkollë mbeten sjelljet individuale të drejtuesve dhe mbikëqyrësve. Në radhë të parë një drejtues duhet të diskutojë vazhdimisht lidhur me komunikimin etik në shkollën ku ai drejton. Kjo do të thotë se mënyra e përcaktuar e komunikimit duhet që të rishikohet herë pas here, për t'u sjellë në pajtim me stadin e zhvillimit moral dhe të nevojave aktuale të shoqërisë. Rishikimi i mënyrave të komunikimit, si një teknikë e përdorur këto vitet e fundit, është një metodë efikase për të kontrolluar politikat e komunikimit, procedurat, rrjetin dhe tërë aktivitetet e tij. Gjuha e ndërlikuar renditet si një ndër problemet më serioze të komunikimit efektiv. Në një komunikim etik, që bazohet në kodet e përpunuara të etikës, në rregullat e adoptuara, apo në kuadron tjetër të pranuar, ka rëndësi gjithashtu, që të zgjidhet forma e dhënies së informacionit.

A duhet që ky informacion të jepet në mënyrë të drejtpërdrejt, me gojë (në telefon, etj.) apo me shkrim (letra, libra, gazeta, reklama, etj.)? Pra rëndësia e një komunikimi efektiv në shkollë lidhet ngushtë me përpunimin e gjykimeve etike dhe me vendimmarrjen, e cila duhet të jetë moralisht e drejtë. Kështu një nga detyrat thelbësore profesionale të mësimitdhënësit është organizimi i bashkëpunimit të mësimitdhënësit me prindërit e nxënësve që ata të plotësojnë veprimtarinë pedagogjike, duke krijuar një formë të caktuar të ndikimit prindëror. Në sistemin e marrëdhënieve “mësimitdhënësit dhe prindërit janë pjesëmarrës”, mësimitdhënësi tërhiqet nga domosdoshmëria objektive dhe nga vetë kushtet e realizimit të procesit pedagogjik. Ky sistem marrëdhëniesh është i aftë të funksionojë edhe pa kontakt të drejtpërdrejt të pjesëmarrjes së tyre, pasi ata i lidh nxënësi si objekt i ndikimit të përbashkët.

Problemi i bashkëpunimit të mësimitdhënësit me nxënësit në dritën e teorisë praktike komunikative, metodat e zhvillimit të kompetencave komunikative në procesin e komunikimit, teknika e

¹⁶ Orhani Z., “Motivacioni”, Panteon, Tiranë, 2000, f.192,

komunikimit pedagogjik kanë nevojë për një përpunim shtesë, si në nivel të ndërtimit teorik përgjithësues, ashtu edhe në nivel rekomandimesh teorikopraktike.¹⁷

Pedagogjia është një sferë e veprimtarisë njerëzore e cila karakterizohet nga përgjegjësia në rritje e mësimitdhënësit për kulturën e të folurit. Kultura e komunikimit të mësimitdhënësit ka specifikën e vet dhe duhet të jetë e formuluar në mënyrë të përcaktuar. Mësimitdhënësi është një figure publike dhe e folura e tij profesionale është e lidhur ngushtë me etikën dhe retorikën e tij pedagogjike. Në thelb mësimitdhënësi është personalitet krijues, me vlera dhe i orientuar, i aftë vazhdimisht për të ndryshuar dhe për t'u përsosur. Zotërimi i suksesshëm i profesionit pedagogjik nuk mundet pa zotërimin e të folurit kulturor dhe komunikimit kulturor.

Natyrisht performanca e mësimitdhënësit dhe e shkollës si dhe klima e klasës mund të sjellë prurje të reja, që duken se dalin jashtë planifikimit paraprak të orës së mësimit, por pavarësisht prej saj, edhe kur flasin edhe kur dëgjojnë, edhe kur evokojnë njohuri, edhe kur realizojnë kuptime apo zhvillojnë refleksione, partnerët në komunikim, mësimitdhënësi dhe nxënësit, hyjnë në një proces të gjallë ku shkëmbehen ide dhe mesazhe, vështrime dhe sinjale, shenja dhe gjeste shpesh simbolike dhe metaforike, por gjithsesi shprehëse dhe mbresëlënëse. “Sapo fillon komunikimi, të dyja palët e ndiejnë se brenda tyre dhe midis tyre diçka lëviz. Është një lëvizje, që shpreh një gjendje të re psikike. E ndryshme nga gjendja psikike e mëparshme, kur palët nuk qenë të përfshira në komunikim me njëra-tjetrën.”¹⁸ Mësimitdhënësi ka marrëdhënie të përditshme me njerëz të ndryshëm, kjo për arsye shtetërore apo private. Për të realizuar këto marrëdhënie, paraprakisht kërkohet një vlerësim racional, para se të komunikojë me një njeri i duhet të dijë:¹⁹

- Me cilin komunikon (subjekti),
 - Përse komunikon (motivi, qëllimi, përfundimi),
 - Për çfarë komunikon (konteksti ose brendia e komunikimit),
 - Metoda e komunikimit, (përsëritje, rrëfim, bisedë, replikë),
 - Sjellja gjatë komunikimit (etika , stili, takti)

¹⁷ Sadker, M.P. & Sadker, D.M, Teachers, School and Society (Mësuesi, shkolla, shoqëria), Tiranë, Eureka, 1995, f. 25.

¹⁸ Çomo B., Psikologji komunikimi: refleksione dhe ligjërata, Tiranë. Pegi, 2001, f. 51.

¹⁹ Dedja, B. Sekretet e Talentit, traktat, Toena, Tiranë 1998, f. 167

Pa dyshim se komunikimi i ndërsjellë i drejtorit dhe mësimehdhënësve në kuadër të shkollës është një prej faktorëve kyç të krijimit të klimës punuese në shkollë. Komunikimi i mësimehdhënësit me nxënësit dhe prindërit e tyre krijon lehtësira në efektshmërinë e punës së tij mësimore. Komunikimi me udhëheqësin e shkollës arsimtarëve u mundëson marrje më të lehtë të informacioneve dhe transmetim më të lehtë të kërkesave lidhur me nevojat e tyre materiale dhe profesionale por edhe të natyrave të tjera. Pra, komunikimi i mirë i mësimehdhënësit me këto faktorë që përbëjnë strukturën e “dukshme” të shkollës është një ndër faktorët më të rëndësishëm të motivimit të tij në punën e tij mësimore dhe në aktivitetin shkollor dhe jashtëshkollor që ka të bëjë me procesin edukativ dhe arsimor.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për tu përgatitur ky punim janë përdorur këtë metoda: metoda e analizës teorike, metoda e sintezës, metoda përshkruese, metoda krahasuese (komparative), metoda statistikore. Studimi empirik kërkon mund dhe kohë, dalje në terren dhe analizë të informative që do nxirren nga pyetësorët.

Përmes metodës së analizës kemi analizuar literaturën përkatëse që lidhet me objektin e hulumtimit dhe përgjigjet e dhëna në pyetësor, të cilat i kemi përmbledhur përmes metodës së sintezës. Me anë të metodës statistikore kemi paraqit të dhëna statistikore dhe në fund përmes metodës përshkruese kemi përshkruar rezultatet e hulumtimit.

Si instrumente për mbledhjen e të dhënave kemi përdorë PYETËSORËT PËR DREJTOR, MËSIMDHËNËS dhe PRINDËR të dy shkollave fillore në këtë komunë. Do të paraqiten pyetësor të cilët do tu përgjigjen drejtorët e këtyre shkollave: një shkollë private dhe një publike në komunën e Gjilanit. Në shkollën fillore ‘Musa Zajmi’ Gjilan shkollë publike me 600 nxënës dhe 52 mësimitdhënës, ku 11 meshkuj dhe 41 janë femra do të realizohet pyetësor me 20 pyetje dhe në fund do të bëhet elaborimi i përgjigjeve në forma statistikore dhe me grafikone.

Njëkohësisht do të realizohet edhe një pyetësor tjetër në shkollën fillore ‘Hello Academy of Education’ është shkollë private me 400 nxënës, e cila ka 40 mësimitdhënës ku 27 janë femra dhe 13 meshkuj.

Në pyetësorin për drejtor të shkollave në gjithsej 20 pyetje ndoshta dhe me shumë, të cilat lidhen me punën dhe detyrat e drejtorit dhe rolit të tij në menaxhimin e shkollës në komunën e Gjilanit dhe do të shqyrtojmë nëpërmjet përgjigjeve raportet që kanë mësimitdhënësit dhe drejtorët. Pyetësoi do të përmbaje pyetje për të dhënat personale, për gjininë, moshën, kualifikimin, të dhënat mbi përvojën e punës profesionale si mësimitdhënës dhe si drejtorë. Nga kjo do nxjerrim dhe përgjigjen se pak ka femra në pozicione të drejtuesit.

Në pyetëtorët për mësimdhënësit në këto dy shkolla të paracaktuara, do të anketohen gjithsej 20 mësimdhënësit dhe në pyetëtorët për prindër në këto dy shkolla do të anketohen 20 prindër. Pyetje do të jenë nga fusha e interesimit tonë, nga përgjigjet e tyre do nxjerrim një elaborim të gjerë, dhe përmes paraqitjeve grafike do ta japim dhe një pasqyrë të qartë të gjendjes së komunikimit dhe raportit që ka mësimdhënësit dhe drejtori në këtë drejtim. Gjithsesi do të marrim parasysh dhe kuadrot e reja të cilat realisht janë dhe shpresa e kapërcimit të kësaj gjendje në të mirë të përparimit të shkollës. Do theksoj në veçanti rolin e mësimdhënëseve femra dhe anashkalimin e tyre për pozicione drejtor - sekretar, është kjo një gjendje e shoqërisë partiarkale apo thjesht përcaktimi politik dhe diferencës gjinore?!


HULUMTIMI PËR BASHKËPUNIMIN DHE KOMUNIKIMIN DREJTOR - MËSIMDHËS NË SHKOLLAT FILLORE TË KOMUNËS SË GJILANIT

Studimi në terren është bërë brenda një periudhe katër mujore. Fillimisht kemi përgatitur pyetësorët dhe të njëjtit janë konsultuar dhe pranuar nga mentori i temës. Kemi bërë terreni e duhur dhe terminet për t'i takuar drejtorët e shkollave dhe mësimeve. Variablat e punimit janë pikërisht dy drejtorët dhe mësimeve. Mostrën e kemi gjetur në bashkëpunim permanent me mentorin, por nuk kemi lënë anësh dhe konsultimet e profesorëve të cilët më kanë ligjëruar në kohën e studimeve të ciklit të dytë.

Fillimisht kemi caktuar kohën e përshtatshme që të takojmë dy drejtorët. Kjo punë ka qenë e vështirë përshkak të pandemisë së virusit Covid-19. Biseda është bërë fillimisht me emejl dhe me telefon dhe më pas ua kam dërguar pyetjet dhe kam marrë përgjigjet në kopjet fizike të pyetësorit. Ngjashëm kam vepruar dhe me mësimeve. Mësimeve janë më shumë në numër dhe punën e kam pas më të vështirë me to. I kam thirr madje dhe në telefon për t'i konsultuar rreth asaj që duhet të përgjigjen.

Ndoshta ka zgjat më shumë se çka mendohej puna e hulumtimit në terren por gjithçka është bërë nëpër një situatë frike dhe pasigurie për shkak të pandemisë. Por ja që në fund morrëm rezultatet e terrenit dhe të njëjtat po ua prezentoj më poshtë përmes pyetësorëve, grafikoneve dhe tabelave dhe fare në fund të punimit do të ngjes modelin e pyetësorit.


Rezultatete e pyetësorit me prindërit në shkollën private “Hello Academy of Education”- Gjilan



Grafikoni 1.Gjinia – ‘Hello Academy of Education’


Hello Academy of Education’ është shkollë private me 400 nxënës, e cila ka 40 mësime të cilat ku 27 janë femra dhe 13 meshkuj. Grafikoni i parë na tregon rreth gjinisë së prindërve që janë anketuar në shkollën Hello Academy - of Education, këtu kemi 44% prindër të gjinisë mashkulore dhe 56% të gjinisë femërore.

MOSHA




Grafikoni 2. Moshë – ‘Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se kemi të anketuar të moshës 36-45 janë 60% dhe 40% janë të moshës 26-35.



Grafikoni 3. Edukimi – ‘Hello Academy of Education’


Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se edukimi i prindërve sillet rreth 50% janë me fakultet, 30% janë me shkollë të mesme dhe 20% janë me master.



Grafikoni 4. Pozita – ‘Hello Academy of education’

Pozita e të anketuarëve janë të gjithë prindër. Më poshtë do të vazhdojmë me komentimin e rezultateve të tjera të pyetjeve tjera të prindërve.


Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj?



Grafikoni 5. Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj? ‘Hello academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se prindërit janë të angazhuar 90% në sistemin arsimor kurse vetëm 10% janë të angazhuar mirë në porcesin edukativo arsimor.

Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës?



Grafikoni 6. Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës? ‘Hello Academy of Education’

Grafikoni në fjalë flet rreth kënaqshmërisë dhe bashkëpunimit me udhëheqësin e shkollës 80% e prindërve janë shumë mirë të kënaqur kurse 20% janë mirë .


Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ?



Grafikoni 7. Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ? ‘Hello Academy of Education’

Sipas grafikunit në fjalë kemi prindër që mendojnë se shumë mirë ë kanë bashkëpunimin midis prindërve dhe shkollës.


Sa jeni te përfshirë në organet e shkollës si institucion i rëndësishëm shoqëror?



Grafikoni 8. Sa jeni te përfshirë në organet e shkollës si institucion i rëndësishëm shoqëror? ‘Hello Academy of Education’

Sipas këti grafikoni mund të shikojmë se 10% e prindërve janë shumë pak të përfshirë në organet e shkollës, 10% janë pak, 10% deri në një masë, 50% janë mirë kurse 20% janë shumë mirë të përfshirë në organet e shkollës.


Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë?



Grafikoni 9. Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë? ‘Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se është i rëndësishëm kontributi i tyre si prind në shkollë, 90% kanë deklaruar se shumë mirë, kurse deri në një masë 10% deri në një masë.


Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ?



Grafikoni 10. Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ? ‘Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se prindërit janë të angazhuar në vendimarrjen e shkollës, 10% asnjëherë nuk kanë qenë, 20% rrallë, 10% ndonjëherë, 40% shpesh dhe 20% gjithmonë.


Jeni pjesë e vizionit të shkollës?



Grafikoni 11. Jeni pjesë e vizionit të shkollës? ‘Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se prindërit janë pjesë e vizionit të shkollës, 10% asnjëherë nuk kanë qenë, 20% rrallë, 10% ndonjëherë, 40% shpesh dhe 20% gjithmonë kanë qenë pjesë e vizionit të shkollës.


Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë?



Grafikoni 12. Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë? ‘Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni kuptojmë se prindërit janë pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë, 10% kanë deklaruar se rrallë, 20% kanë deklaruar se ndonjëherë, 10% kanë deklaruar se shpesh, 60% kanë deklaruar se gjithmonë.


I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës?



Grafikoni 13. I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës?’Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se prindërit i japin prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës.


A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ?



Grafikoni 14.A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ?’Hello Academy of Education’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se të gjithë prindërit mendojnë se janë pjesë e suksesit në shkollë.


A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësime dhënëse dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arriturave të shkollës si institucion edukativo – arsimor ?



Grafikoni 15.A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësime dhënëse dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arriturave të shkollës si institucion edukativo – arsimor ?'Hello Academy of Education'

Po ashtu të gjithë prindërit pajtohen se bashkëpunimi mes drejtorit dhe mësime dhënëse ndikon në ngritjen e shkollës si institucion edukativo arsimorë.


A jeni të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë ?



Grafikoni 16.A jeni të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë ?'Hello academy of Education'

Sipas këtij grafikoni shikojmë se janë të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë të gjithë prindërit.


Rezultatete e pyetësorit me prindërit në shkollën shtetërore “ Musa Zajmi “ – Gjilan



Grafikoni 17.Gjinia – ‘Musa Zajmi’ - Gjilan


Grafikoni i parë na tregon rreth gjinisë së prindërve që janë anketuar në shkollën M.Zajmi, këtu kemi 44% prindër të gjinisë femërore dhe 56% të gjinisë mashkullore.

MOSHA




Grafikoni 18. Moshë – ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni shikojmë se 50-50 janë të moshë 26-35 dhe 36-45.



Grafikoni 19. Edukimi – ‘Musa Zajmi’


Sipas këtij grafikoni kuptojmë se 17% janë me master, me SHLP janë 17%, me shkollë të mesme janë 33%, kurse me fakultet janë 33% .



Grafikoni 20. Pozita - ‘Musa Zajmi’

Pozita e të anketuarëve janë të gjithë prindër. Më poshtë do të vazhdojmë me komentimin e rezultateve të tjera të pyetjeve tjera të prindërve.


Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj?



Grafikoni 21. Sa jeni të angazhuar në procesin edukativo-arsimor në shkollën e fëmijës tuaj? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni në shkollën “Musa Zajmi” 40% kanë deklaruar se shumë pak, 40% pak kurse deri në një masë 20%.


Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës?



Grafikoni 22. Sa është i kënaqshëm bashkëpunimi juaj me udhëheqësin e shkollës? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni 10% shumë mirë janë të kënaqur me bashkëpunimin me udhëheqësin e shkollës, , 20% pak, 50% deri në një masë, 20% mirë.


Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ?



Grafikoni 23. Sa mendoni se është i suksesshëm bashkëpunimi në mes juve ? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se prindërit e M.Zajmi deklarojnë se është i suksesshëm bashkëpunimi, këtë e thanë se 30% mendojnë se mirë është suksesi dhe bashkëpunimi, 10% kanë deklaruar se shumë mirë, 40% kanë deklaruar deri në një masë dhe 20% kanë deklaruar se pak.


Sa jeni te përfshirë në organet e shkollës si institucion i rëndësishëm shoqëror?



Grafikoni 24. Sa jeni te përfshirë në organet e shkollës si institucion i rëndësishëm shoqëror? ‘Musa Zajmi’

Sipas grafikoni 24 shohim se prindërit janë deklaruar 33% janë pak të përfshirë në organet e shkollës, 25% deri në një masë, 17% shumë mirë, 17% shumë pak dhe 8 % mirë.


Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë?



Grafikoni 25. Sa mendoni se është i rëndësishëm kontributi juaj si prind në shkollë? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të kuptojmë se është i rëndësishëm kontributi i tyre si prind në shkollë, 90% kanë deklaruar se shumë mirë, kurse deri në një masë 10%.


Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ?



Grafikoni 26 Jeni pjesë e vendimmarrjes në shkollë ? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se 40% kanë deklaruar se asnjëherë, rrallë 40% kurse ndonjëherë 20%.


Jeni pjesë e vizionit të shkollës?



Grafikoni 27. Jeni pjesë e vizionit të shkollës? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se 30% janë ndonjëherë pjesë e vizionit të shkollës M.Zajmi, 40% janë shpesh herë dhe 30% janë rrallë.


Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë?



Grafikoni 28. Jeni pjesë e aktiviteteve të realizuara në shkollë? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se 38% gjithmonë kanë qenë pjesë e aktiviteteve shkollore në shkollë M.Zajmi, 37% kanë deklaruar se rrallë, 19% kanë deklaruar se ndonjëherë, dhe 6% kanë deklaruar se shpesh.


I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës?



Grafikoni 29. I jepni prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni shikojmë se 77% kanë dhënë prioritet kërkesave nga ana e drejtorit të shkollës M.Zajmi, kurse 23% kanë deklaruar se shpesh.


A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ?



Grafikoni 30. A mendoni se jeni pjesë e suksesit në shkollë ? ‘Musa Zajmi’

Sipas këtij grafikoni mund të shikojmë se të gjithë prindërit mendojnë se janë pjesë e suksesit në shkollë.


A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësimeve dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arriturve të shkollës si institucion edukativo – arsimor ?



Grafikoni 31. A pajtoheni se bashkëpunimi në mes drejtorit, mësimeve dhe prindërve ndikon në ngritjen e të arriturve të shkollës si institucion edukativo – arsimor ? ‘Musa Zajmi’

Po ashtu të gjithë prindërit pajtohen se bashkëpunimi mes drejtorit dhe mësimeve ndikon në ngritjen e shkollës si institucion edukativo arsimorë.


A jeni të kënaqur me punën që zhvillohet në shkollë ?



